

Nr. 1466/2 Prot.

Durrës, më 10.06.2025

VENDIM

Nr. 61, datë 10.06.2025

PËR

"MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË REGJISTRIN E PARASHIKIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN KALENDARIK 2025"

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*"; Vendimit Nr. 53, datë 19.08.2021 të Bordit të Administrimit "*Për miratimin e Rregullores Financiare të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës*"; në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 4, datë 24.01.2025; si dhe në shkresën e Administratorit me Nr. 1236/3 prot., datë 29.05.2025 "*Kërkesë për një ndryshim në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për vitin kalendarik 2025*", vendimit të Senatit Akademik nr.68, datë 04.06.2025, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik, për vitin kalendarik 2025, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas shkresës së Administratorit me Nr. 1236/3 prot., datë 29.05.2025 bashkëlidhur.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi:
 - Administratori
 - Drejtoria e Prokurimeve dhe Investimeve
 - Drejtoria e Administrimit Financiar

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

